



MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT
mes
SHOQATA E MIQËSISË KOSOVË-AUSTRI
Dhe
KOMUNA E PODUJEVËS

Për
SHËNIMIN E PËRVITSHËM TË DITËS SË
SHTETËSISË SË SHTETIT TË AUSTRISË

Tetor, 2024



Preambula

Ky memorandum i mirëkuptimit ka për qëllim sigurimin e bashkëpunimit mes dy institucioneve nënshkruese. Me këtë rast, Shoqata e Miqësisë Kosovë - shpreh interesimin që të bashkëpunojnë me Komunën e Podujevës me rastin e shënimit të ditës së shtetësisë të shtetit të Austrisë, në shenjë dhe simbolik të rëndësisë së bashkëpunimit mes dy shteteve tona në lëmi të ndryshme, si dhe me qëllim të thellimit të bashkëpunimit mes dy shteteve mike.

Neni 1

Palët

Palë të këtij memorandum i janë Komuna e Podujevës dhe Shoqata e Miqësisë Kosovë-Austri.

Neni 2

Qëllimi

Me nënshkrimin e këtij memorandum i palët dakordohen që të bashkëpunojnë me qëllim që të zbatohet objektivi i përcaktuar i këtij memorandum, përkatësisht shënjimi përvitshëm i Ditës së Shtetësisë së Austrisë në Komunën e Podujevës më datën 26 tetor.

Neni 3

Zotimet e palëve

Në kuadër të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, Komuna e Podujevës merr përsipër zotimin që me datën e lartcekur (26 tetor) të secilit vit të ngritë në shtizë para objektit të saj (objektit të Komunës) flamurin e shtetit të Austrisë, krahas flamurit shtetëror të Kosovës, në shenjë të respektit dhe miqësisë mes dy shteteve tona.

Shoqata e Miqësisë Kosovë-Austri merr përsipër që me rastin e nënshkrimit të Memorandumi të Mirëkuptimit të bëjë dorëzimin ceremonial dhe simbolik të flamurit të Austrisë tek Kryetari i Komunës së Podujevës.

Me rastin e nënshkrimit të këtij MM, Komuna e Podujevës nuk ka asnjë kosto apo obligim financiar.

Arsim VRANOVCI

Avokat,
President i Shoqatës Kosovë-Austri



Shpejtim BULLIQI,

Kryetar i Komunës së Podujevës